

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ Fafa Konstruksion ” sh.p.k.**

Sot, më datë 08/01/2020 , në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

**Z. FATOS ÇERENISHTI** shtetas shqiptar, lindur ne Polican Skrapar më 12.01.1970 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr.H00112088G madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

vendos të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**FAFA KONSTRUKSION** Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**  
**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Blu Kamez, Zona Kadastrale 8320, nr. pasurie 1/138-ND, Volumi 3, faqe 153.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3**  
**Objekti**



### 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:


Investime,pjesmarrje në fushën industriale, duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, ndërtimore,industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistonë në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimitari në fushën e shit-blerjes si dhe të gjithë formave të qerase apo të shfrytëzimit të pasurive të patundshme. Realizimin e kontratave marveshjeve,ortakerive dhe shoqërive të përbashkëta. Tregtimin, magazinim me pakicë dhe shumicë të karburanteve, lubrifikanteve, lëndëve djegëse, të lëngshme dhe të gazta brënda dhe jashtë vendit. Kërkim, zbulim, shfrytëzim, minierash etj

### Neni 4 Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

### Neni 5 Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 **Leke** ( njëqind mijë)
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetëm ,100% ne 1 kuotë .
- Z.FATOS ÇERENISHTI** shtetas shqipatr, lindur ne Polican Skrapar më datë 12.01.1970 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr. **H00112088G** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontributet në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.



**Neni 6**  
**Asambleja e Përgjithshme**

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

**Neni 7**  
**Administratori**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

**Z. Ali Çerenishti** shtetas shqipat, lindur më Vëndreshë e madhe Skrapar me date 10.03.1958 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr. F80310242N madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

**Neni 8**  
**Viti Financiar**




- 8.1 Viti finansiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2020.

**Neni 9**  
**Të ndryshme**

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 kopje originale në gjuhën shqipe.

**ORTAKU**

Fatos Çerenishti

  
Fatos Çerenishti  
Lepushe